



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV
Sesioni pranveror
Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 57
Prishtinë, më 19 qershor 2013, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Petar Miletqi dhe Emilija Rexhepi.

Mungoi: Enis Kervan, Sabri Hamiti, Berat Buzhala dhe Skender Hyseni.

Pjesëmarrës të tjerë: Petrit Hysaj – OSBE, Vlora Nushi – OPA/SRSG, Blerta Bejtullahu – EUSR/EU Office, Naim Jakaj – VV, Lumnije Murati – ZPRK dhe mediet.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe praktikantet Gurjeta Zeka e Tringa Bytyqi.

Mbledhjen e kryesoi: Albin Kurti, Kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 20 maj 2013;
3. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të planit të zbatimit për këtë marrëveshje;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 20 maj 2013

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 20 maj 2013.

3. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare

Albin Kurti, informoi anëtarët e Komisionit se Grupi Punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për marrëveshje ndërkombëtare, është takuar javën e kaluar dhe ka kërkuar që puna e tyre të mbështetet nga ndonjë institut, apo ekspert. Ai njoftoi për mundësinë e angazhimit të ndonjë instituti apo eksperti, dhe për kushtet e kompensimit financiar për shërbimin të cilin eksperti ia ofron Komisionit, sipas Udhëzimit për administrimin e buxhetit të komisioneve parlamentare.

Hydajet Hyseni, tha se edhe pse NDI po e redukton angazhimin në Kuvend, përfaqësuesit e tij kanë siguruar një mbështetje adekuate. Mirëpo, theksoi nevojën edhe për një ekspertizë të mëtejshme, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare. Gjithashtu, njoftoi se në një konferencë të organizuar nga Instituti Friedrich Ebert Stiftung është dhënë pëlqimi në parim që të mbështetet Komisioni.

Pas diskutimit lidhur me nevojën për ekspertizë sipas propozimit të Grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare, kryetari konstatoi se Komisioni e nxori këtë

P ë r f u n d i m

Angazhohet instituti Grupi për Studime Juridike dhe Politike i përfaqësuar nga eksperti Dren Doli, që të përgatisë ekspertizën sipas termave të referencave, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare, për 10 ditë pune.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të planit të zbatimit për këtë marrëveshje

Albin Kurti lidhur me Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të planit të zbatimit për këtë marrëveshje, tha se Kryesia e Kuvendit e ka ngarkuar Komisionin për Legjislacion që ta shqyrtoj këtë Projektligj, megjithatë në këtë takim është radhitur për shqyrtim nga Komisioni ynë, në cilësi të Komisionit të interesuar. Gjithashtu, njoftoi se nuk ka përgjigje ende nga ftesa e cila i është bërë Kryeministrit më 11 shkurt, për të raportuar në Komision, për çështjen e dialogut politik me Serbinë në Bruksel, ndërsa në ftesën dërguar Ministrit të jashtëm më 23 maj, tani, disa minuta para takimit kemi përgjigjen.

Hydajet Hyseni theksoi se Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të planit të zbatimit për këtë marrëveshje, sot nuk do të mund të shqyrtohet në aspektin përmbajtësor por vetëm nga aspekti procedural dhe për të zënë hapin se si të vazhdohet më tutje. Theksoi se personalisht është për marrëveshje, por se nuk duhet lejuar që të nxitohet për ta proceduar marrëveshjen pa u përgatitur të gjitha kushtet e nevojshme. Propozoi që Komisioni të kërkojë që të ushtroj funksionin e tij, në cilësi të komisionit funksional në shqyrtimin e marrëveshjes ndërkombëtare sepse është gabim të anashkalohet Komisioni në këtë rast dhe rastet e tjera të marrëveshjeve ndërkombëtare. Ai tha se sipas Rregullores së Kuvendit në fushëveprimtarinë e Komisionit për Punë të Jashtme, përfshihet ratifikimi në bllok ose ndaras i traktateve ekzistuese të cilat Kosova dëshiron t'i nënshkruaj dhe citoi edhe pikat e tjera në kompetencë të Komisionit, për të cilat tha se Komisioni nuk përfshihet. Pajtohet që Komisioni për legjislacion të shqyrtoj marrëveshjen në cilësi të komisionit kryesor, por jo në cilësi të komisionit funksional. Sipas ligjit në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare tha se, marrëveshja ndërkombëtare duhet ta ketë preambulën, titullin, titullarët dhe nënshkruesit.

Kjo marrëveshje që është në procedurë është pa titull, nuk është e sqaruar kush me kënd e lidh këtë marrëveshje. Në marrëveshje janë dy nënshkrime, ku nuk është thënë në çfarë cilësie ata e nënshkruajnë këtë marrëveshje, si kryeministra, si përfaqësues të dy palëve, si përfaqësues të shteteve, gjë që është e domosdoshme për trajtim në mënyrë adekuate të marrëveshjes. Përmbajtja e tekstit të marrëveshjes është e diskutueshme, a bie në domenin e çështjeve ndërkombëtare apo të atyre të brendshme. Nëse një marrëveshje është e karakterit ndërkombëtarë, duhet të respektohen procedurat ndërkombëtare nga Konventa e Vjenës dhe të obligohen të dyja palët që ta ratifikojnë, përndryshe krijohen raporte të asimetrisë, tha Hyseni.

Donika Kadaj-Bujupi shprehu befasinë se lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, nuk ju është shpërndarë asnjë dokument, ndërsa në anën tjetër kërkohet që të shqyrtohet kjo çështje. Si anëtare e këtij Komisioni tha se ka ardhur në përfundim që çdo gjë që lidhet me Komisionin dhe nevojën që të dëgjohet një zë ndryshe, zakonisht bëhen përpjekje që të anashkalohet ky Komision. Sikur ta kishim përgjegjësin për dialog të pranishëm tha se, do ta shprehte shqetësimin e saj lidhur me çështjen e gjykatave ilegale në veri dhe informatën në media për pranimin e atyre vendimeve si të ligjshme. Shqetësim tjetër shprehu lidhur me faktin që institucionet, veçanërisht Qeveria, i kushtojnë më tepër rëndësi formës së takimeve përmes publikimeve të fotografive nga Brukseli, që lënë përshtypjen se çdo gjë është në rregull, ndërsa mungon informata për substancën e takimeve që po ndodhin.

Petar Miletic theksoi se në këtë takim nuk do të diskutojë lidhur me qëndrimin e tij politik dhe të partisë së tij, pasi që atë do ta bëjë në seancë plenare, ndërsa pajtohet që të diskutohet lidhur me problemet procedurale të këtij Projektligji, i cili përmban gjithsej 4 nene. Ai tha se Komisioni për Punë të Jashtme mund të diskutojë lidhur me Marrëveshjen dhe planin e zbatimit të saj dhe të ftojë Kryeministrin, Ministrin e jashtëm dhe Zëvendëskryeministrin Tahiri për të diskutuar, por jo kështu në shpejtësi. Si përfaqësues i komunitetit serb tha se është shumë i interesuar që të arrihet deri tek implementimi i Marrëveshjes dhe së bashku me bashkatdhetarët e tij në veri t'i fillojnë bisedimet në mënyrë serioze për institucionalizimin e jetës atje. Theksoi se Komisioni për Punë të Jashtme është anashkaluar nga procedura për ta shqyrtuar këtë Projektligj dhe nuk është hera e parë që kjo po ndodhë. Ai tha që Komisioni ka të drejtë dhe detyrë ta përcjellë zbatimin e këtij Projektligji dhe planit të zbatimit të marrëveshjes, dhe inkurajon Komisionin në mbikëqyrjen e zbatimit të tij, duke e ftuar edhe zëvendëskryeministrin Kuçi që t'i ofroj Komisionit, informata më të sakta.

Albin Kurti theksoi se Komisioni për Punë të Jashtme është anashkualar për ta shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të planit të zbatimit për këtë marrëveshje. Njoftoi se, as Kryeministri Thaqi, e as Ministri i jashtëm Hoxhaj, nuk kanë ardhur në Komision për t'i përshkruar detajet e procesit të dialogut politik në Bruksel. Ai theksoi se kjo Marrëveshje nuk e ka formën e marrëveshjes ndërkombëtare, nuk është e nënshkruar por vetëm e parafuar me iniciale në dy dokumente të ndara, që duket si të jenë të nënshkruar nga individë e jo nga kryeshtetërorë. Serbia ende nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës, prandaj tha se kjo Marrëveshje nuk është ndërkombëtare.

Ngutjen që të ratifikohet Marrëveshja nga Kosova, ai e konsideron gabim strategjik, dhe sugjeron që të pritet derisa Bundestagu gjerman ta jap mendimin e tij për çështjen e integritetit evropian të Serbisë dhe për hapat e mëtejshëm. Pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve të pavarura në punën e grupeve punuese gjatë bisedimeve ai e kundërshton dhe e vlerëson si të paligjshme dhe jashtë çdo norme kushtetuese. Po ashtu theksoi se, neni 11 dhe neni 5 i Ligji për marrëveshjet ndërkombëtare nuk janë marrë për bazë me rastin e kësaj marrëveshjeje, dhe se kjo marrëveshje do të shkakton më shumë segregim se integrim.

Emilija Redzepi lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të planit të zbatimit për këtë marrëveshje, tha se jemi në vonesë që ta shqyrtojmë. Theksoi se është obligim i Qeverisë dhe pjesëmarrësve në këtë dialog që për punën e tyre në procesin e dialogut ta njoftojnë Komisionin, në mënyrë që edhe anëtarët e Komisionit të japin kontributin e tyre në këtë proces.

Albin Kurti theksoi Komisioni për Punë të Jashtme është anashkualar edhe gjatë procesit të dialogut por edhe tani në përfundim të tij, gjë që e konsideroi si shkelje dhe padrejtësi ndaj Komisionit.

Takimi përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti